

Hulumtim

Niveli i ekspozimit ndaj tymit të duhanit dhe qëndrimet e qytetarëve lidhur me politikat e kontrollit të duhanit në Kosovë



Prishtinë, 31 maj 2020

Përmbajtja

HYRJE	3
METODOLOGJIA	4
PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE KRYESORE	6
TË GJETURAT E HULUMTIMIT	7
1. PËRDORIMI I DUHANIT.....	7
1.1. <i>Duhanpirja</i>	7
1.2. <i>Pirja e duhanit në mesin e meshkujve dhe të femrave</i>	7
2. EKSPOZIMI NDAJ TYMIT TË DUHANIT	8
2.1. <i>Ekspozimi ndaj tymit të duhanit në bare, kafene dhe restorante</i>	8
2.2. <i>Ekspozimi ndaj tymit të duhanit në vendin e punës</i>	8
2.3. <i>Ekspozimi i ndaj tymit të duhanit në shtëpi (jo duhanpirësit)</i>	9
2.4. <i>Ekspozimi i ndaj tymit të duhanit në shtëpi (duhanpirësit)</i>	9
3. QËNDRIMET E POPULLATËS NDAJ NDALIMIT TË PIRJES SË DUHANIT NË VENDET PUBLIKE	10
3.1. <i>Qëndrimet e popullatës ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në bare, kafene dhe restorante</i>	10
3.2. <i>Qëndrimet e popullatës ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në institucione publike</i>	10
3.3. <i>Ndikimi i pirjes së duhanit në përzgjedhjen e bareve, kafeneve dhe restoranteve</i>	11
4. ZBATIMI I NDALIMIT TË PIRJES SË DUHANIT NË VENDIN E PUNËS	11
5. NIVELI I KËNAQËSHMËRISË SË POPULLATËS ME PUNËN E AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN E NDALIMIT TË PIRJES SË DUHANIT	12
6. PERCEPTIMI I EFEKTIVITETIT TË VËREJTJEVE SHËNDETËSORE NË PAKOT E DUHANIT	12
6.1. <i>Perceptimi i efektivitetit të vërejtjeve shëndetësore me tekst</i>	12
6.2. <i>Ndikimi i vërejtjeve shëndetësore me tekst tek jo-duhanpirësit që të mos fillojnë duhanpirjen</i> .	13
6.3. <i>Ndikimi i vërejtjeve shëndetësore me tekst tek duhanpirësit për të pirë më pak duhan</i>	13
6.4. <i>Ndikimi i vërejtjeve shëndetësore me tekst tek duhanpirësit për të lënë duhanin</i>	14
6.5. <i>Perceptimi i efektivitetit të vërejtjeve shëndetësore me fotografi</i>	14
7. PËRDORIMI I CIGAREVE ELEKTRONIKE DHE SHISHËS.....	15
7.1. <i>Përdorimi i Cigareve Elektronike</i>	15
7.2. <i>Përdorimi i Shishës</i>	15
PËRFUNDIMI	16
TË DHËNAT SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE GJEOGRAFIKE	19
ANEKS I – PYETËSORI: NIVELI I EKSPOZIMIT NDAJ TYMIT TË DUHANIT DHE QËNDRIMET E QYTETARËVE PËR POLITIKAT E KONTROLLIT TË DUHANIT	22

Hyrje

Përdorimi i duhanit është i shkaktari më i madh i vdekjeve në të gjithë botën i cili mund të parandalohet. Çdo vit, rreth shtatë milion vdekje i atribuohen përdorimit të duhanit.¹ Mesatarisht, përdoruesit e duhanit humbasin 15 vjet jetë. Gjysma e përdoruesve të duhanit nga numri i tyre i përgjithshëm do të vdesin para kohe nga shkaqe që lidhen me duhanin për çdo vit. Shumica e këtyre vdekjeve do të ndodhë në vendet me të ardhura të mesme dhe të ulëta të cilat llogariten se do të përbëjnë gati 80 për qind të të gjitha vdekjeve që lidhen me duhanin.² Kosto ekonomike e përdorimit të duhanit është jashtëzakonisht e madhe. Më shumë se 1.4 trilion dollarë amerikanë vlerësohet të jetë kosto e kujdesit shëndetësor dhe e humbjes së produktivitetit, shumë e cila përbën rreth 1.8 për qind të Bruto Prodhimit Vendor të të gjithë botës dhe mbi 40 për qind të vlerës së përgjithshme të shpenzimeve botërore që shkojnë për edukim shkollor.³

Megjithatë, duhani mbetet i vetmi produkt që shkakton varësi i cili është gjerësisht i disponueshëm dhe ende mund të blihet në mënyrë të ligjshme në çdo vend.

Në nivel global Konventa Kornizë për Kontrollin e Duhanit (FCTC) e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) është nisma më e rëndësishme globale për kontrollin e duhanit. Strategjia kryesore që përdoret për të zbatuar FCTC-në është MPOWER. Kjo strategji paraqet një paketë të asistencës teknike të zhvilluar nga OBSH që përbëhet nga gjashtë masa të bazuara në dëshmi shkencore për uljen e kërkesës së duhanit të cilat janë të përfshira në FCTC. Këto masa përfshijnë kërkesat si më poshtë:

Monitoroni politikat e përdorimit dhe parandalimit të duhanit; **M**broni njerëzit nga tymi i duhanit; **O**froni ndihmë për të lënë duhanin; **P**aralajmëroni për rreziqet e duhanit; **Z**batoni ndalimet për reklamimin, promovimin dhe sponsorizimin e duhanit; dhe **R**ritni taksat mbi duhanin.

Që nga koha kur OBSH prezantoi MPOWER në dekadën e kaluar ka pasur përparime të konsiderueshme në miratimin e politikave të forta të kontrollit të duhanit në të gjitha rajonet e botës, si në mesin e vendeve të zhvilluara ashtu edhe të atyre me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Këto arritje në një kohë relativisht të shkurtër kanë qenë mbresëlënëse - gati dy të tretat e popullatës së botës (4.7 miliardë) janë të mbrojtur nga të paktën një masë e kontrollit të duhanit, 3.6 miliardë më shumë njerëz sesa u mbuluan në mënyrë të ngjashme vetëm një dekadë më parë. Sidoqoftë, 2.7 miliardë njerëz ende nuk kanë mbrojtje nga sëmundjet, paaftësitë dhe vdekjet e shkaktuara nga përdorimi i duhanit dhe ekspozimi ndaj tymit të duhanit apo nga dëmet ekonomike, mjedisore dhe sociale që shkakton duhani.⁴

¹ WHO report on the global tobacco epidemic, 2017: monitoring tobacco use and prevention policies. Geneva: World Health Organization; 2017. Licence: CC BY-NC-SA 3.0 IGO

² WHO Report on the Global Tobacco Epidemic, 2008: The MPOWER package. Geneva, World Health Organization, 2008

³ Goodchild M, Nargis N, Tursan d'Espaignet E Global economic cost of smoking attributable diseases Tobacco Control 2018;27:58-64

⁴ WHO report on the global tobacco epidemic, 2017: monitoring tobacco use and prevention policies. Geneva: World Health Organization; 2017. Licence: CC BY-NC-SA 3.0 IGO

Në nivel kombëtar, krahas vendeve tjera të botës liderë në mbrojtjen e shëndetit publik, dhe para vendeve të rajonit, në maj të vitit 2013 Kosova miratoi Ligjin për Kontrollin e Duhanit i cili përfshin shumicën e masave të rekomanduara të FCTC-së.

Ligji për Kontrollin e Duhanit u hartua nga Ministria e Shëndetësisë dhe u aprovua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme nga pasojat shkatërruese shëndetësore, sociale, ekonomike dhe mjedisore të duhanit, dhe përcakton një sërë masash. Përveç tjerash, me këtë ligj ndalohej pirja e duhanit në hapësirat e mbyllura publike, vendet e punës dhe mjetet e transportit publik. Të gjitha format e reklamimit, promovimit dhe sponsorizimit të duhanit, duke përfshirë edhe vendosjen e produkteve të duhanit në pikat e shitjes janë të ndaluara. Gjithashtu është e obligueshme vendosja e vërejtjeve shëndetësore me fotografi në paketimet e cigareve.⁵

Duke njohur rëndësinë e të dhënave të përdorimit të duhanit për të udhëzuar qeverinë e një vendi për masat dhe veprimet që duhet të ndërmerren për mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga duhani, Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC) ka realizuar një hulumtim të gjerë në shkallë vendi.

Ky hulumtim ka për qëllim parësor matjen e nivelit të ekspozimit të popullatës ndaj tymit të duhanit, vlerësimin e efektivitetit të politikave të kontrollit të duhanit dhe hulumtimin e qëndrimeve të popullsisë së Kosovës ndaj këtyre politikave. Të gjeturat e këtij hulumtimi duhet të shërbejnë si dëshmi të bazuara në prova për të orientuar dhe udhëzuar Qeverinë Kosovës dhe autoritetet përgjegjëse - zbatuese të ligjit në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për përmirësimin e implementimit të politikave të kontrollit të duhanit në Kosovë.

Metodologjia

Në mënyrë të hollësishme, nëpërmjet këtij studimi KADC ka hulumtuar përdorimin e duhanit; ekspozimin ndaj tymit të duhanit në bare, kafene dhe restorante, në vendin e punës dhe në shtëpi; qëndrimet e popullatës ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në vende publike; zbatimin e ndalimit të pirjes së duhanit në vendin e punës; nivelin e kënaqëshmërisë së popullatës me punën e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ndalimi të pirjes së duhanit; efektivitetin e vërejtjeve shëndetësore në pakot e duhanit dhe ndikimin e tyre në konsumimin e duhanit; përdorimin e cigareve elektronike dhe shishes.

Ky studim është mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe është realizuar prej datës 13 deri 23 shkurt, 2020.

Metoda e zgjedhur për mbledhjen e të dhënave në këtë studim mbështetet në intervistat individuale “ballë për ballë” të realizuara me 1060 persona të moshës 18 vjeçare e më të vjetër të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme në 15 komuna të Kosovës. Nga gjithsej 1060 pyetësorë - 1000 mostra të pyetësorëve të plotësuar janë vlerësuar si të vlefshëm, 50 pyetësorë janë përdorë për intervista provuese nga ana e intervistuesve, 10 pyetësorë janë konsideruar si jo të vlefshëm dhe nuk janë marrë parasysh gjatë përpunimit së të dhënave.

⁵ LIGJ PËR KONTROLLIN E DUHANIT, Ligji Nr. 04/L-156

Komunat e përzgjedhura për studim përfshijnë gjithsej 15 komuna: 7 qendra kryesore rajonale – Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Gjiilan dhe 8 komuna më të vogla – Podujevë, Obiliq, Rahovec, Klinë, Therandë, Kaçanik, Vushtrri dhe Kamenicë. Numri i të anketuarve nga secila komunë është përafërsisht proporcional me numrin e banorëve të komunës përkatëse⁶. Ky studim nuk përfshin komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës.

Dizajnim i studimit ka qenë i tillë që për çdo lagje të secilës komunë të synuar janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme dhjetë ose më pak persona të moshës 18 vjeç e më të vjetër me përhapje të barabartë sipas gjinisë⁷. Personat e anketuar kanë shkallë të ndryshme të edukimit dhe punësimit dhe ushtrojnë një varg të gjerë profesione⁸. Shumica prej tyre jetojnë në zona urbane⁹. Asnjë nga të anketuarit nuk është paguar për kompletimin e intervistës.

Për realizimin e anketimit KADC ka angazhuar nëntë anketues të cilët kanë mbaruar studimet universitare ose kanë qenë në përfundim të tyre. Të gjithë anketuesit e përzgjedhur kanë ndjekur një trajnim një-ditor gjatë të cilit është diskutuar në mënyrë sistematike për secilën pyetje në pyetësor. Atyre u është ligjësuar në mënyrë specifike për kontrollin e duhanit dhe aplikimin e masave të kontrollit të duhanit si në vendin tonë ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Programi i trajnimit gjithashtu ka përfshirë intervistat demonstruese, intervistat simuluese dhe intervistat praktike në lagjet e afërta urbane.

Tabelimi i të dhënave dhe analiza statistikore e tyre është realizuar nëpërmjet të programit SPSS (Statistical Package for Social Sciences). Të dhënat e përfituara janë nxjerrë nga procedimi i 1000 mostrave të pyetësorëve të plotësuar enkas për këtë studim, çka siguron një marzhë të gabimit jo më të madhe se 3%.

⁶ Tabela 6

⁷ Tabela 1, 2

⁸ Tabela 3, 4

⁹ Tabela 5

Përmbledhje e të gjeturave kryesore

1. Përdorimi i duhanit

- 37.7% e kosovarëve mbi moshën 18 vjeçare janë duhanpirës **të rregullt**. Ndërsa 11.5% e popullatës pinë duhan **herë pas here**.
- Në mesin e duhanpirësve që rregullisht pinë duhan, 45.8% janë meshkuj dhe 29.9% femra.

2. Ekspozimi ndaj tymit të duhanit në bare, kafene dhe restorante, në vendin e punës dhe në shtëpi

- **Në bare, kafene dhe restorante 81.4%** e kosovarëve i ekspozohet rregullisht tymit të duhanit, 14.8% nuk i ekspozohet tymit të duhanit dhe 3.8% e të anketuarve nuk i vizitojnë lokalet.
- **Në vendin e punës 27%** e popullatës rregullisht apo shpesh i ekspozohet tymit të duhanit derisa 49% nuk i janë ekspozuar tymit të duhanit, prej tyre 20.2% gati kurrë dhe 28.8% kurrë.
- **Në shtëpi çdo i treti jo duhanpirës (33%) dhe duhanpirës (31.2%)** i ekspozohet tymit të duhanit.

3. Qëndrimet e popullatës ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në vende publike

- **84.7%** e popullatës janë shprehur **në favor** të ndalimit të pirjes së duhanit **në bare, kafene dhe restorante**, ndërsa **15.3%** e popullatës janë **kundër** ndalimit të pirjes së duhanit.
- **98.5%** e popullatës janë shprehur **në favor** të ndalimit të pirjes së duhanit **në institucione publike**, ndërsa vetëm **1.5%** e popullatës janë **kundër** ndalimit të pirjes së duhanit.
- **40.7%** e të anketuarve janë shprehur që i përzgjedhin vendet ku **nuk pihet duhan** brenda, 28.7% i vizitojnë ato lokale **ku lejohet pirja e duhanit** (në kundërshtim me Ligjin) dhe 30.6% janë shprehur që lejimi apo ndalimi i pirjes së duhanit **nuk ndikon** në vendimin e tyre për t'i vizituar ato.

4. Zbatimi i ndalimit të pirjes së duhanit në vendin e punës

- 54.8% janë përgjigjur se pirja e duhanit **nuk lejohet askund** në ambiente të mbyllura.
- 7.8% janë përgjigjur se pirja e duhanit **lejohet vetëm në një dhomë** të veçantë për pirje të duhanit.
- 9.3% janë përgjigjur se pirja e duhanit **lejohet në disa zona** por jo kudo brenda ndërtesës.
- 7.5% janë përgjigjur se pirja e duhanit **nuk është aspak e kufizuar**.

5. Niveli i kënaqëshmërisë së popullatës me punën e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e Ligjit

- 94.5% e popullatës janë të pa kënaqur me punën e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ndalimit të pirjes së duhanit në vende publike. 4.2% e popullatës mendon që autoritetet përgjegjëse kanë bërë punë të mirë për zbatimin e ndalimit të pirjes së duhanit në vendet publike.

6. Efektiviteti i vërejtjeve shëndetësore në pakot e duhanit dhe ndikimi i tyre në konsumimin e duhanit

- **20.9%** e të anketuarve janë shprehur se janë **shumë efektive**, 25.6% **disi efektive**, 25.4% **jo shumë efektive** dhe **27.9%** e të anketuarve janë shprehur aspak efektive.
- **30.5%** e të anketuarve fotografitë ilustruese mbi ndikimet shëndetësore të duhanit i percepton **shumë efektive**, 39.2% **disi efektive**, 21.6% **jo shumë efektive** dhe 8.3% **aspak efektive**.
- **Tek 49.7% e jo duhanpirësve** mesazhet me tekst nuk ndikojnë **që ata të mos fillojnë duhanin**.
- **Tek shumica e duhanpirësve (85.2%)** mesazhet me tekst nuk ndikojnë **që ata të pinë më pak duhan**. Vetëm **4.7%** e tyre i konsideron mesazhet me tekst të jenë shumë efektive.
- **Tek shumica e duhanpirësve (85.5%)** mesazhet me tekst nuk ndikojnë **që ata të lënë duhanin**.

7. Përdorimi i cigareve elektronike dhe shishes

- **Përdorimi i cigareve elektronike** në baza ditore është 0.8% ndërsa **përdorimi i shishës** 1.5%.
- **Së paku njëherë** 17.6% e popullatës e kanë përdorur cigaren elektronike dhe 24.5% shishen.


Të gjeturat e hulumtimit

1. Përdorimi i duhanit

1.1. Duhanpirja


37.7% e kosovarëve mbi moshën 18 vjeçare janë duhanpirës të rregullt. Ndërsa 11.5% e popullatës pinë duhan herë pas here. 50.8% e popullatës nuk pinë duhan. Prej tyre 40.7% kurrë nuk ka pirë duhan derisa 10.1% prej tyre janë ish duhanpirës që e kanë lënë duhanin.

Pirja e Duhanit



1.2. Pirja e duhanit në mesin e meshkujve dhe të femrave


Nga të anketuarit të cilët pinë duhan **rregullisht** 45.8% janë meshkuj. Në përqindje meshkujt pinë duhan **më shumë** se femrat (29,9%), derisa **herë pas here** femrat (14.3%) pinë duhan më shumë se meshkujt (8.6%). 42.7% e femrave dhe 34% të meshkujve kurrë nuk kanë pirë duhan. Në përqindje më të madhe meshkujt (11.6%) e kanë lënë duhanin se sa femrat (8.6%).



2. Ekspozimi ndaj tymit të duhanit


2.1. Ekspozimi ndaj tymit të duhanit në bare, kafene dhe restorante

Njëri prej qëllimeve kryesore të studimit ka hulumtimi i ekspozimit ndaj tymit të duhanit në vendet publike të cilat shpesh frekuentohen nga qytetarët. Hulumtimi ka gjetur se ekspozimi më i madh i qytetarëve ndaj tymit të duhanit është pikërisht në bare, kafene dhe restorante. Në pyetjen a i ekspozoheni tymit të duhanit në bare, kafene dhe restorante, 81.4% e të anketuarve janë shprehur se çdo herë (37.8%) i ekspozohen tymit të duhanit dhe 43.6% i ekspozohen shpesh. Vetëm 10.9% janë shprehur se gati kurrë ose 3.9% asnjëherë nuk i janë ekspozuar tymit të duhanit. 3.8% janë shprehur që nuk i vizitojnë fare baret, kafenetë dhe restorantet.




2.2. Ekspozimi ndaj tymit të duhanit në vendin e punës

Përveç ekspozimit ndaj tymit të duhanit në shtëpi është hulumtuar edhe ekspozimi ndaj tymit të duhanit në vendin e punës. Në pyetjen a i ekspozoheni tymit të duhanit në vendin tuaj të punës, 27% e të anketuarve janë shprehur që për çdo ditë (12.2%) dhe shpesh (14.8%) i ekspozohen tymit të duhanit. 28.8% kurrë dhe 20.2% gati kurrë nuk i janë ekspozuar tymit të duhanit në vendin e punës. Një pjesë e të anketuarve 24% janë shprehur që nuk punojnë jashtë shtëpisë.




2.3. Ekspozimi i ndaj tymit të duhanit në shtëpi (jo duhanpirësit)

Në pyetjen e shtruar jo duhanpirësve se a pi duhan ndonjë person që jeton me ju në shtëpi, 33% e të anketuarve janë shprehur pozitivisht ndërsa 66.2% janë shprehur që askush nuk pi duhan brenda shtëpisë. Një përqindje e vogël e të anketuarve jeton vetëm 0.8%.



2.4. Ekspozimi i ndaj tymit të duhanit në shtëpi (duhanpirësit)


Nga të gjithë të anketuarit duhanpirës, 17.7% janë të vetmit ata që pinë duhan në shtëpi, 21.9% pinë duhan bashkë me dikë tjetër në shtëpi. Tymit të duhanit në shtëpi nga një person tjetër i ekspozohen 9.3% e të anketuarve duhanpirës. Gjithsej 31.2% janë të ekspozuar ndaj tymit të duhanit në shtëpi të duhanpirësve.



3. Qëndrimet e popullatës ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në vendet publike


3.1. Qëndrimet e popullatës ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në bare, kafene dhe restorante

Kur jemi të pyetur rreth qëndrimeve ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në bare, kafene dhe restorante shumica e të anketuarve janë për zbatimin rigoroz të ligjit në mbrojtje dhe ruajtje të shëndetit publik. 84.7% e të anketuarve janë shprehur në favor, prej tyre 62.3% plotësisht në favor dhe 22.4% pjesërisht në favor. Ndërkaq një pjesë e vogël 15.3% e të anketuarve janë shprehur kundër ndalimeve të pirjes së duhanit në bare, kafene dhe restorante.




3.2. Qëndrimet e popullatës ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në institucione publike

Të pyetur rreth qëndrimeve mbi ndalimin e pirjes së duhanit në institucione publike duke përfshirë qeverinë, komunat, universitetet, shkollat, spitalet etj. një shumicë dërmuese prej 90.1% janë shprehur plotësisht në favor dhe 8.4% janë shprehur pjesërisht në favor. Vetëm 1.5% e të anketuarve janë shprehur kundër ndalimeve.




3.3. Ndikimi i pirjes së duhanit në përzgjedhjen e bareve, kafeneve dhe restoranteve

Shkelja e ligjit për kontrollin e duhanit dhe lejimi i pirjes së duhanit në bare, kafene dhe restorante ndikon në disa mënyra në përzgjedhjen e të anketuarve për frekuentimin e tyre. Në pyetjen a ndikon ndikon pirja e duhanit në përzgjedhjen e lokaleve që i vizitoni, 40.7% e të anketuarve janë shprehur se përzgjedhin baret, kafenetë dhe restorantet ku **nuk pihet duhan** brenda, 28.7% e tyre janë shprehur që i vizitojnë ato lokale **ku lejohet pirja** e duhanit dhe për 30.6% e të anketuarve lejimi apo ndalimi i pirjes së duhanit **nuk ndikon** në vendimin e tyre për t'i vizituar ato.




4. Zbatimi i ndalimit të pirjes së duhanit në vendin e punës

Studimi ka hulumtuar zbatimin e ndalimit të pirjes së duhanit në vendin e punës. Në pyetjen çfarë përshkruan më së miri kufizimet e pirjes së duhanit në vendin tuaj të punës, 54.8% e të anketuarve janë shprehur se pirja e duhanit **nuk lejohet askund** në ambiente të mbyllura, 7.8% thonë që pirja e duhanit **lejohet vetëm në një dhomë** të veçantë për pirje të duhanit, 9.3% thonë që pirja e duhanit **lejohet në disa zona** por jo kudo brenda ndërtesës, 7.5% pirja e duhanit **nuk është aspak e kufizuar** dhe 18.7% e të anketuarve janë shprehur që nuk punojnë në hapësirë të mbyllur.



5. Niveli i kënaqshmërisë së popullatës me punën e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ndalimit të pirjes së duhanit

Lidhur me zbatimin e ligjit qytetarët janë pyetur se a mendojnë që autoritetet përgjegjëse kanë bërë sa duhet për të zbatuar ndalimin e pirjes së duhanit në vendet publike. **94.5%** e popullatës janë të pa kënaqur me punën e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ndalimit të pirjes së duhanit në vende publike. Prej tyre 28.5% mendojnë që autoritetet përgjegjëse aspak nuk kanë bërë, 23.9% kanë bërë tejet pak dhe 42.1% mendojnë që autoritetet përgjegjëse kanë bërë pak. Një përqindje vogël **4.2%** mendon që autoritetet përgjegjëse kanë bërë shumë për zbatimin e ndalimit të pirjes së duhanit në vendet publike.




6. Perceptimi i efektivitetit të vërejtjeve shëndetësore në pakot e duhanit

Vërejtjet apo paralajmërimet shëndetësore me tekst janë kërkuar të vendosen në pakot e cigareve para shumë viteve. Etiketat e para janë zbatuar në Islandë në vitin viti 1969. Studimi ka hulumtuar perceptimin e efektivitetit të mesazheve shëndetësore me tekst të cilat gjenden në pakot e duhanit tek duhanpirësit dhe jo duhanpirësit.


6.1. Perceptimi i efektivitetit të vërejtjeve shëndetësore me tekst

Në pyetjen kur mendoni për mesazhet (vërejtjet) shëndetësore me tekst në pakot e duhanit, sa ju informojnë ato për efektet shëndetësore të duhanit, 27.9% e të anketuarve janë shprehur aspak efektive, 25.4% jo shumë efektive, 25.6% disi efektive dhe 20.9% janë shprehur se janë shumë efektive.




6.2. Ndikimi i vërejtjeve shëndetësore me tekst tek jo-duhanpirësit që të mos fillojnë duhanpirjen

Tek 49.7% e jo duhanpirësve mesazhet me tekst nuk ndikojnë që ata të mos fillojnë duhan pirjen, 31.1% e të anketuarve i percepton mesazhet me tekst si aspak efektive dhe 18.6% si jo shumë efektive. 16.9% e të anketuarve i percepton mesazhet me tekst disi efektive dhe 32% si shumë efektive.




6.3. Ndikimi i vërejtjeve shëndetësore me tekst tek duhanpirësit për të pirë më pak duhan

Tek shumica e duhanpirësve apo 85.2% e të anketuarve mesazhet me tekst nuk ndikojnë që ata të pinë më pak duhan. Vetëm 4.7% e tyre i konsideron mesazhet me tekst të jenë shumë efektive. 30.7% prej tyre i konsiderojnë mesazhet me tekst jo shumë efektive dhe 10.1% disi efektive.




6.4. Ndikimi i vërejtjeve shëndetësore me tekst tek duhanpirësit për të lënë duhanin

Edhe tek shumica e duhanpirësve (85.5%) mesazhet me tekst nuk ndikojnë që ata të lënë duhanin. Për më shumë, në pyetjen se nëse këto mesazhe ndikojnë në lënien e duhanit më shumë se gjysma e tyre 57.8% janë përgjigjur se mesazhet me tekst janë aspak efektive, 27.7% i konsiderojnë jo shumë efektive dhe 10% e të anketuarve i konsiderojnë disi efektive.



6.5. Perceptimi i efektivitetit të vërejtjeve shëndetësore me fotografi

Në pyetjen sa efektive do të ishte shtimi i një fotografie me ngjyra e cila ilustron efektet shëndetësore të duhanpirjes në forcimin e vërejtjeve shëndetësore nga vërejtjet që janë vetëm me tekst, të anketuarit janë më optimistë. 30.5% e të anketuarve i percepton si **shumë efektive** fotografitë ilustruese mbi ndikimet shëndetësore të duhanpirjes, 39.2% **disi** efektive, 21.6% si **jo shumë** efektive dhe 8.3% **aspak** efektive.




7. Përdorimi i Cigareve Elektronike dhe Shishës

Niveli i përdorimit të cigareve elektronike dhe shishës përmes të cilave në veçanti joshet rinia është në rritje në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Kosova nuk është e përjashtuar nga ky trend. Tregu i cigareve elektronike dhe shishave në vendin tonë ka filluar të zhvillohet me hapjen e dyqaneve të specializuara për shitjen e shishave dhe cigareve elektronike duke promovuar dhe nxitur konsumimin e këtyre produkteve sidomos tek të rinjtë.


7.1. Përdorimi i Cigareve Elektronike

Për çdo ditë cigare elektronike përdorin 0.8% e popullatës, 1.7% përdorin herë pas here, 1.1% kanë përdorur cigare elektronike rregullisht por e kanë ndaluar, ndërsa 17.6% kanë provuar së paku njëherë dhe 78.8% nuk ka përdor kurrë cigare elektronike.



7.2. Përdorimi i Shishës

Për dallim nga cigaret elektronike trendi i përdorimit të shishes është në rritje më të madhe. Për çdo ditë e përdorin shishen 1.5% e popullatës, 6.8% herë pas here, 1.1% e kanë përdorur rregullisht por e kanë ndaluar, 23.5% e kanë provuar të paktën një herë dhe 67.1% e të anketuarve janë shprehur që kurrë nuk e kanë provuar shishen. Sikurse te cigaret elektronike edhe tek përdorimi i shishes cak kryesor i industrisë së duhanit janë të rinjtë.



Përfundimi

Përdorimi i Duhanit

Përkundër fushatave të ndryshme vetëdijësuese dhe përpjekjeve të shoqërisë për zbatimin e ligjit për kontrollin e duhanit, shprehia e duhanpirjes në Kosovë me 37.7% mbetet ende në nivel të lartë. Në mesin e duhanpirësve që rregullisht pinë duhan, 45.8% janë meshkuj dhe 29.9% femra.

Ekspozimi ndaj tymit të duhanit në bare, kafene dhe restorante, në vendin e punës dhe në shtëpi

Ankesat e shpeshta të qytetarëve që ligji për kontrollin e duhanit nuk po respektohet në bare, kafene e restorante dhe që ata vazhdimisht janë të ekspozuar ndaj tymit të duhanit ishte njëra ndër arsyt kryesore që të hulumtohet ekspozimi ndaj tymit të duhanit. Gjetjet e hulumtimit kanë vërtetuar se ekspozimi i qytetarëve ndaj tymit të duhanit është shumë i madh (81.4%) në bare, kafene dhe restorante. Për dallim prej bareve, kafeneve dhe restoranteve në vendin e punës ekspozimi është më i ulët 27%. Nivele të njëjta të ekspozimit janë hasur edhe brenda shtëpive, ku çdo i treti qytetar, 33% e jo duhanpirësve dhe 31.2% e duhanpirësve i ekspozohet tymit të duhanit.

Në dy vitet e para menjëherë pas miratimit të ligjit për kontrollin e duhanit në maj të vitit 2013, zbatimi i ligjit ishte në nivel të duhur. Faktorët që ndikuan në uljen e zbatimit janë të shumëfishtë. Inspektimi jo i rregullt dhe i mjaftueshëm, procedimi me vonesë i lëndëve të duhanit në gjykatë dhe vakumi institucional që gjithmonë krijohet pas zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë janë disa prej faktorëve. Sidoqoftë, niveli i zbatimit të ligjit për kontrollin e duhanit ka shënuar përparim të dukshëm në institucionet publike, shëndetësore dhe edukative. Sektori i gastronomisë ishte dhe mbetet sektori ku më së shumti shkelet masa e ndalimit të 100% të pirjes së duhanit.

Qëndrimet e popullatës ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në vende publike

Qytetarët e Kosovës janë shprehur fuqimisht në favor të politikave të kontrollit të duhanit që ndalojnë pirjen e duhanit në vende publike. Hulumtimi ka gjetur se shumica e qytetarëve të Kosovës (84.7%) përkrahin ndalimin e përdorimit të duhanit në kafene, bare dhe restorante dhe 98.5% në institucione publike. Hulumtimi ka treguar që ndalimi i pirjes së duhanit në bare, kafene dhe restorante ndikon në vendimin e qytetarëve për ti vizituar ato. 40.7% e qytetarëve i përzgjedhin lokalet ku nuk pihet duhan brenda, 28.7% i vizitojnë lokalet ku lejohet pirja e duhanit (në kundërshtim me Ligjin) dhe për 30.6% lejimi apo ndalimi i pirjes së duhanit nuk ndikon në vendimin e tyre për t'i vizituar ato.

Është momenti i fundit që autoritetet zbatuese të ndërmarrin hapat e domosdoshëm për zbatimin e ligjit dhe masës 100% të ndalimit të pirjes së duhanit në ambiente të mbyllura ashtu siç është e shkruar në Ligj. Ndalimi 100% i përdorimit të duhanit në mjedise të mbyllura mbron shëndetin jo vetëm të jo-duhanpirësve por edhe të vet duhanpirësve duke pamundësuar duhanprijen pasive për të gjithë. Ndalimi i pirjes së duhanit në vende publike gjithashtu kontribuon në de-normalizimin e kulturës së duhanpirjes dhe ndihmon në masë të madhe në parandalimin e nisjes së përdorimit të duhanit tek të rinjtë.

Zbatimi i ndalimit të pirjes së duhanit në vendin e punës

Pirja e duhanit në gjysmën e vendeve të punës (54.8%) nuk lejohet askund në ambiente të mbyllura, në 7.3% lejohet vetëm në një dhomë të veçantë për pirje të duhanit, në 9.3% lejohet në disa zona por jo kudo brenda ndërtesës dhe në 7.5% të vendeve të punës pirja e duhanit nuk është aspak e kufizuar.

Niveli i kënaqshmërisë së popullatës me punën e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e Ligjit

Si rrjedhojë e ekspozimit të lartë dhe të vazhdueshëm ndaj tymit të duhanit në sektorin e gastronomisë dhe të ekspozimit në vendin e punës, perceptimi i publikut për punën e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ligjit është në nivel shumë të ulët. 94.5% e popullatës janë të pa kënaqur me punën e tyre.

Efektiviteti i vërejtjeve shëndetësore në pakot e duhanit dhe ndikimi i tyre në konsumimin e duhanit

Përkundër faktit që në vitin 2013 është miratuar Ligji për Kontrollin e Duhanit sipas të cilit kërkohet që tre vjet pas miratimit të tij në pakot e duhanit të vendosen vërejtjet shëndetësore të ilustruara me fotografi, në Kosovë edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të shiten pakot e duhanit me vërejtje shëndetësore me tekst. Më shumë se gjysma e të anketuarve (53.3%) vërejtjet shëndetësore me tekst i percepton si jo efektive. Tek 49.7% e jo-duhanpirësve mesazhet me tekst nuk ndikojnë që ata të mos fillojnë duhan pirjen. Tek shumica e duhanpirësve (85.2%) mesazhet me tekst nuk ndikojnë që ata të pinë më pak duhan dhe vetëm 4.7% e tyre i konsideron mesazhet me tekst të jenë shumë efektive. Për shumicën e duhanpirësve (85.5%) mesazhet me tekst nuk ndikojnë që ata të lënë duhanin.

Udhëzimi Administrativ i cili përcakton rregullat për vendosjen e fotografive me ngjyra apo ilustrimeve tjera dhe tekstit në paketimet e produkteve të duhanit është përpiluar qysh në vitin 2016. Interferenca e industrisë së duhanit në nivele të larta të politikë-bërjes në Kosovë ka ndikuar në dobësimin dhe vonimin e zbatimit politikave për mbrojtjen e shëndetit publik. Një ndër to është edhe Udhëzimi Administrativ për vërejtjet shëndetësore me fotografi që ende qëndron i mbyllur në sirtarët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe nuk është nënshkruar nga asnjëri prej ministrave të shëndetësisë deri më sot.

Në Botë dhe në Evropë kanë lëvizur në drejtim të pakove të standardizuara të cilat krahas vendosjes së fotografive ilustruese në tërë madhësinë e pakos së duhanit nuk lejojnë vendosjen e çfarëdo teksti që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë promovon duhanin apo kompanitë e duhanit. Në Kosovë 69.7% e të anketuarve i konsiderojnë efektive fotografitë ilustruese mbi ndikimet shëndetësore të duhan pirjes.

Mbi 122 vende në gjithë Botën kanë zbatuar vendosjen e vërejtjeve shëndetësore me fotografi ilustruese në pakot e duhanit. Mirëpo, sot një numër gjithnjë e më i madh i shteteve janë duke lëvizur edhe më tutje duke rregulluar me ligj shitjen e duhanit me pako të standardizuara. Sipas OBSH-së pakot e standardizuara e rrisin efektivitetin e vërejtjeve shëndetësore duke i bërë pakot e duhanit më pak atraktive dhe duke parandaluar përdorimin e pakove për reklamim dhe promovim të duhanit.

Përdorimi i cigareve elektronike dhe shishes

Niveli i përdorimit të cigareve elektronike dhe shishës përmes të cilave në veçanti joshet rinia është në rritje në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Kosova nuk është e përjashtuar nga ky trend. Tregu i cigareve elektronike dhe shishave në vendin tonë ka filluar të zhvillohet me hapjen e dyqaneve të specializuara për shitjen e shishave dhe cigareve elektronike duke promovuar dhe nxitur konsumimin e këtyre produkteve. Përveç kësaj alarmues është reklamimi i këtyre produkteve dhe cigareve nga industria e duhanit në mediat sociale e sidomos përmes këngëtarëve apo aktorëve që pëlqehen nga të rinjtë.

Të dhënat socio-demografike dhe gjeografike

Gjinia

Hulumtimi ka përfshirë pothuajse në mënyrë të barabartë meshkujt dhe femrat. Ndarja sipas gjinisë e të anketuarve është 49.1% femra dhe 50.9% meshkuj.

Tabela 1

Gjinia	Të anketuar	Përqindja
Mashkull	491	49.1%
Femër	509	50.9%

Mosha

Hulumtimi është i ndarë në pesë grup mosha. 34.6% e të anketuarve janë të grup moshës prej 18 deri 25, 26.4% janë prej 26 deri 35, 16.3% janë prej 36 deri 45, 17.8% janë prej 46 deri 60 dhe 4.7% e të anketuarve janë mbi moshën 61 vjeç.

Tabela 2

Mosha	Të anketuar	Përqindja (%)
18-25	346	34.6%
26-35	264	26.4%
36-45	163	16.3%
46-60	178	17.8%
61+	47	4.7%

Edukimi

Edukimi mban një rol të rëndësishëm në pirjen ose jo të duhanit. Të pyetur se cilën shkollë e kanë kryer, 3.7% e të anketuarve janë shprehur se kanë kryer shkollën fillore, 34.2% kanë kryer shkollën e mesme, 46% kanë kryer fakultetin, 15.7% kanë kryer studimet pasuniversitare dhe 0.4% janë të pa shkolluar.

Tabela 3

Edukimi	Të anketuar	Përqindja (%)
Shkollën fillore	37	3.7%
Shkollën e mesme	342	34.2%
Fakultetin	460	46,0%
Studimet pasuniversitare	157	15.7%
I pa shkolluar	4	0.4%

Profesioni

Hulumtimi ka përfshirë qytetarë të profesioneve të ndryshme. Janë hulumtuar disa lloje të profesioneve dhe punësimeve prej të vet punësuarve, punonjës, punëtor fizik dhe pa një aktivitet profesional. 20.4% e të anketuarve janë të vet punësuar me profesione të ndryshme si fermer, pylltar, pronar dyqani, zejtar, avokat, mjek, menaxher i një kompanie, etj. 47.5% janë të punësuar në institucione publike ose private si drejtor, menaxher, nëpunës civil apo në zyre, shitës, etj. 4.3% e të anketuarve janë punëtor fizik dhe 27.8% pa ndonjë aktivitet profesional student, në pension, në kërkim të ndonjë pune, etj..

Tabela 4

Profesioni dhe punësimi		Të anketuar	Përqindja (%)
I vet punësuar	Fermer, pylltar, peshkatar	9	0.9
	Pronar i një dyqani, zejtar	73	7.3
	Profesionist (avokat, mjek, kontabilist, arkitekt..)	26	2.6
	Menaxher i një kompanie	49	4.9
	Të tjera	47	4.7
Gjithsej		204	20.4%
Punonjës	Profesionist (mjek i punësuar, avokat, llogaritar, arkitekt)	99	9.9
	Menaxhim i përgjithshëm, drejtor ose menaxhim i lartë	23	2.3
	Menaxhimi i mesëm	45	4.5
	Nëpunës civil	33	3.3
	Nëpunës zyre	74	7.4
	Punonjës tjetër (shitës, infermier, etj.)	110	11
	Të tjera	91	9.1
Gjithsej		475	47.5%
Punëtor fizik	Mbikëqyrës / drejtues (menaxher i ekipit, etj.)	20	2
	Punëtor fizik	13	1.3
	Punëtor i pakualifikuar fizik	8	0.8
	Të tjera	2	0.2
Gjithsej		43	4.3%
Pa një aktivitet profesional	Kujdesi për shtëpinë	50	5
	Student (me kohë të plotë)	72	7.2
	Në pension	22	2.2
	Kërkimi i një pune	109	10.9
	Të tjera	25	2.5
Gjithsej		278	27.8%

Vendbanimi

Të anketuarit janë pyetur ku banojnë. Pjesa me e madhe prej 82.9% e të anketuarve banon në qytet dhe pjesa tjetër prej 17.1% banon në zona rurale.

Tabela 5

Vendbanimi	Të anketuar	Përqindja (%)
Qytet	829	82.9%
Fshat	171	17.1%

Komunat

Komunat e përzgjedhura për studim përfshijnë gjithsej 15 komuna: 7 qendra kryesore rajonale – Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Gjilan dhe 8 komuna më të vogla – Podujevë, Obiliq, Rahovec, Klinë, Therandë, Kaçanik, Vushtrri dhe Kamenicë. Numri i të anketuarve nga secila komunë është përafërsisht proporcional me numrin e banorëve të komunës përkatëse. Ky studim nuk përfshin komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës.

Tabela 6

Komuna	Të anketuar	Përqindja (%)
Ferizaj	90	9%
Fushë Kosova	30	3%
Gjakovë	100	10%
Gjilan	80	8%
Kacanik	30	3%
Kamenicë	30	3%
Klinë	30	3%
Mitrovicë	90	9%
Obiliq	30	3%
Pejë	100	10%
Prishtinë	180	18%
Prizren	120	12%
Rahovec	30	3%
Suharekë	30	3%
Vushtrri	30	3%

Aneks I – Pyetësi: Niveli i ekspozimit ndaj tymit të duhanit dhe qëndrimet e qytetarëve për politikën e kontrollit të duhanit

KADC është organizatë jo qeveritare e cila për një kohë të gjatë angazhohet për mbrojtjen e dhe ruajtjen e shëndetit të qytetarëve të Kosovës. **Ky pyetësor** ka për qëllim të hulumtoj nivelin e ekspozimit të qytetarëve ndaj tymit të duhanit dhe përkrahjen e publikut për politikën të cilat e ndalojnë pirjen e duhanit në vendet publike. Bashkëpunimi i juaj është shumë i rëndësishëm për të përparuar mbrojtjen e shëndetit publik. Ky projekt mbështetet nga KFOS.

Përdorimi i duhanit

1. Lidhur me pirjen e cigareve, cila nga këto vlen për JU? [Vetëm një përgjigje]

Ju pini duhan çdo ditë	1
Ju pini duhan herë pas here	2
Ju pini duhan por e keni ndal	3
Nuk keni pirë ndonjëherë duhan	4
[ND / SP] ¹⁰	9

P2. Lidhur me pirjen e cigareve elektronike, cila nga këto vlen për ju? [Vetëm një përgjigje]

Ju pini çdo ditë	1
Ju pini herë pas here	2
E keni përdorur rregullisht por e keni ndal	3
Ju e keni provuar të paktën një herë	4
Ju kurrë nuk e keni provuar	5
[ND / SP]	9

P3. Lidhur me përdorimin e shishes, cila nga këto vlen për ju? [Vetëm një përgjigje]

Ju pini çdo ditë	1
Ju pini herë pas here	2
E keni përdorur rregullisht por e keni ndal	3
Ju e keni provuar të paktën një herë	4
Ju kurrë nuk e keni provuar	5
[ND / SP]	9

Ekspozimi ndaj tymit të duhanit në shtëpi

PYETJE E NDARË

Për JO duhanpirës (KODI 3 ose 4 në P1)

P4a. A pi duhan ndonjë person që jeton me ty në shtëpi? [Vetëm një përgjigje]

Jetoni vetëm	1
Askush që jeton me ju nuk pi duhan brenda shtëpisë	2
Dikush që jeton me ju pi brenda shtëpisë	3

¹⁰ [ND / SP] – Nuk Di / Ska Përgjigje

Për duhanpirës (KODI 1, 2 ose 9 në P1)

P4b. A pini JU apo ndonjë person tjetër që jeton me ju duhan në shtëpi? [Vetëm një përgjigje]

Jetoni vetëm	1
Askush prej jush nuk pi duhan brenda shtëpisë	2
Vetëm JU pini duhan brenda shtëpisë	3
Vetëm dikush që jeton me ju pi duhan brenda shtëpisë	4
Edhe ju edhe dikush që jeton me ju pini duhan brenda shtëpisë	5
[ND / SP]	9

Ekspozimi i duhanit të duhanit në punë

P5. Në vendin tuaj të punës, sa ju ekspozoheni tymit të duhanit? [Vetëm një përgjigje]

Çdo ditë	1
Shpesh	2
Gati kurrë	3
Asnjëherë nuk jam ekspozuar	4
[Unë nuk punoj jashtë shtëpisë]	5
[ND / SP]	9

P6. Çfarë përshkruan më së miri kufizimet e pirjes së duhanit në vendin tuaj të punës?

[LEXO ME ZË: Vetëm një përgjigje]	
Pirja e duhanit nuk lejohet askund në ambiente të mbyllura	1
Pirja e duhanit lejohet vetëm në një dhomë të veçantë për pirje të duhanit	2
Pirja e duhanit lejohet në disa zona por jo kudo brenda ndërtesës	3
Pirja e duhanit nuk është aspak e kufizuar	4
[Unë nuk punoj në hapësirë të mbyllur]	5
[ND / SP]	9

Ekspozimi i duhanit në bare, kafene dhe restoranteP7. Në **bare, kafene dhe restorante** sa i ekspozoheni tymit të duhanit? [Vetëm një përgjigje]

Çdo herë	1
Shpesh	2
Gati kurrë	3
Asnjëherë nuk jam ekspozuar	4
[Unë nuk punoj jashtë shtëpisë]	5
[ND / SP]	9

Qëndrimet ndaj kufizimeve të duhanpirjesP8. A jeni në favor të ndalimit të pirjes së duhanit në **bare, kafene dhe restorante**?

[Vetëm një përgjigje]

Plotësisht në favor	1
Pjesërisht në favor	2
Kundër	3
[ND / SP]	9

P9. A jeni në favor të ndalimit të pirjes së duhanit në **institucione publike (qeveri, komunë, universitete, shkolla, spitale)**? [Vetëm një përgjigje]

Plotësisht në favor	1
Pjesërisht në favor	2
Kundër	3
[ND / SP]	9

P 10. A ndikon pirja e duhanit në përzgjedhjen e **bareve, kafeneve dhe restoranteve** që ju i vizitoni? [Vetëm një përgjigje]

Po, i përzgjedh vendet ku nuk pihet duhan brenda	1
Po, i përzgjedh vendet ku pihet duhan brenda	2
Nuk ndikon	3 [ND / SP]

Vërejtjet shëndetësore

P11. Kur mendoni për mesazhet shëndetësore me tekst që gjenden në pakot e duhanit, a janë këto mesazhe shumë efektive, disi efektive, jo shumë efektive apo fare jo efektive fare në secilën nga mënyrat e mëposhtme?

Respondenti është:

Jo duhanpirës	4
Ish duhanpirës	3
Duhanpirës	1, 2, 9

	Shumë efektive	Disi efektive	Jo shumë efektive	Aspak efektive	ND / SP
Duke ju informuar për efektet shëndetësore të duhanit	4	3	2	1	9
Duke ju bindur të mos filloni duhanin	4	3	2	1	9
Duke ju bërë që të pini më pak duhan	4	3	2	1	9
Duke ju bërë që të përpiqeni të lini duhanin	4	3	2	1	9

P12. Sipas mendimit tuaj, sa e efektshme do të ishte shtimi i një fotografie me ngjyra, e cila ilustron efektet shëndetësore të duhanpirjes, në forcimin e vërejtjeve shëndetësore vetëm me tekst? [Vetëm një përgjigje për rresht]

Shumë efektive	4
Disi efektive	3
Jo shumë efektive	2
Aspak efektive	1
[ND / SP]	9

Zbatimi i Ligjit

P13. A mendoni që autoritetet zbatuese kanë bërë sa duhet për zbatimin e ligjit për ndalimin e pirjes së duhanit në vendet publike? [Vetëm një përgjigje]

Shumë	1
Pak	2
Tejet pak	3
Aspak	4
[ND / SP]	9

Të dhëna të përgjithshme

D1. Gjinia

[NUK PYETNI – SHËNONI]

[1] Mashkull

[2] Femër

D2. Sa vjeç jeni?

[] [] vjeç

[00] [Refuzon / NUK PËRGJIGJET]

D3. Edukimi – Ju keni të mbaruar?

Shkollën fillore	1
Shkollën e mesme	2
Fakultetin	3
Studimet pasuniversitare	4
I pa shkolluar	9

D4. Për sa i përket profesionit tuaj aktual dhe punësimit, a jeni i vetëpunësuar, punonjës, punëtor krahu apo pa një aktivitet profesional? Do të thotë që ju jeni një (n) ...

[NËSE JIPET PËRGJIGJJA PËR KATEGORINË KRYESORE, LEXO ME ZË NËN-KATEGORITË]

I vetëpunësuar

dmth: - fermer, pylltar, peshkatar	11
- pronar i një dyqani, zejtar	12
- profesionist (avokat, mjek, kontabilist, arkitekt, ...)	13
- menaxher i një kompanie	14
- të tjera	15

Punonjës

dmth: - profesionist (mjek i punësuar, avokat, llogaritar, arkitekt)	21
- menaxhim i përgjithshëm, drejtor ose menaxhim i lartë	22
- menaxhimi i mesëm	23

- Nëpunësi civil	24
- nëpunës zyre	25
- punonjës tjetër (shitës, infermier, etj.) ...)	26
- të tjera	27
Punëtor	
dmth: - mbikëqyrës / drejtues (menaxher i ekipit, etj ...)	31
- Punëtor krahu	32
- Punëtor i pakualifikuar	33
- të tjera	34
Pa një aktivitet profesional	
dmth: - kujdesi për shtëpinë	41
- student (me kohë të plotë)	42
- në pension	43
- kërkimi i një pune	44
- të tjera	45
- [Refuzim]	99
D6. A jetoni në ...?	
Qytet	2
Fshat	3
[Refuzim]	9
D7. Komuna _____	